



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P 130/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.03.2021 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Modifikimi i dokumenteve standarde të tenderit për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF- 85499-02-01-2021, me objekt “*Shërbim i pastrimit, grumbullimit dhe largimit të mbetjeve të qytetit Cërrik dhe Njësive Administrative*”, me fond limit 24,951,604 lekë pa TVSh, publikuar më datë 02.02.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Cërrik.

**Ankimues:** “Rej” shpk  
Adresa: Lagjja nr. 3, Shëtitorja “Europa”, Pogradec.

**Autoriteti Kontraktor** Bashkia Cërrik.  
Adresa: Rruga “Gjimnazistët 1962”, Lagjja nr. 2, Cërrik.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së*

*Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V ë r e n:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 02.02.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF- 85499-02-01-2021, me objekt “*Shërbim i pastrimit, grumbullimit dhe largimit të mbetjeve të qytetit Cërrik dhe Njësive Administrative*”, me fond limit 24,951,604 lekë pa TVSh, publikuar më datë 02.02.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Cërrik.

II.2. Në datën 08.02.2021, operatori ekonomik “*Rej*” ShPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit me argumentet si më poshtë:

*Ne daten 02/02/2021 jemi informuar per publikimin e Procedures se Prokurimit, Procedure e hapur - Sherbime - Marreveshje Kuader me nje operator ekonomik fitues, ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, afati 365 dite, me objekt “Sherbimi i pastrimit, grumbullimit dhe largimit te mbetjeve te qytetit Cerrik dhe Njesive Administrative” me Autoritet Kontraktor Bashkia Cerrik dhe me fond limit 24.951.604 (njezete e kater milion e nenteqind e pesedhete e nje mije e gjashteqind e kater) leke pa TVSh ne adresen ëëë.app.gov.al*

*Bazuar ne Nenin 63 pika 1/1 i Ligjit Per Prokurimin Publik, paraqesim ankesen si me poshte vijon, mbi Dokumentet Standarde te Tenderit, Publikuar nga Autoriteti juaj.*

*Mbi ankesen: Kapaciteti teknik:*

*1. Në DST, Kriteret e Veçanta për Kualifikim, Kapaciteti Teknik pika 7 kërkohet:*

*Leje Mjedisore të lëshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit për veprimtari që kanë ndikim ndaj mjedisit (Stacion transferimi per mbetje jo te rrezikshme), (Kodi III.1.A)*

*Bazuar në ligjin Nr. 52/2020 PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10448, DATË 14.7.2011, “PËR LEJET E MJEDISIT”, TË NDRYSHUAR*

*Neni 11 Shfuqizime*

*Pas hyrjes ne fuqi te ligjit, cdo parashikim per lejet e mjedisit te tipit C, ne ligjin nr. 162/2014, “Per mbrojtjen e cilesise se ajrit ne mjedis” dhe cdo dispozite tjeter ligjore qe vjen ne kundershtrim me dispozitat e ketij ligji, shfuqizohen.*

*Termi III.1.A ligjerisht i referohet lejes C, bazuar ne ligjin nr 52/2020 per disa ndryshime ne ligjin Nr.10448, date 14/07/2011 “Per lejet e mjedisit”, te ndryshuar, Leja C nuk ekziston me dhe ne keto kushte AK nuk mund te kerkoje nje dokument i cili eshte shfuqizuar.*

*Ne nenin 46, pika 1 germa “a” te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret e meposhtme, qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional: cdo operatori ekonomik i kerkon licencat profesionale industriale apo tregtare, te leshuara nga autoritetet kompetente shteterore, per veprimtarite e kerkuara dhe per te cilat do te lidhet kontrata;*

*Kerkojme te hiqet ky kriter nga kerkesat e vecanta per kualifikim si nje kriter i pabazuar ne Ligj.*

*2. Ne DST, Kriteret e Vecanta per Kualifikim, Kapaciteti Teknik pika 8 kerkohet: Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate me shkrim mbi disponueshmerine e mjeteve, ku te percaktohen te dhenat teknike dhe sasite perkatese per mjetet e meposhtme:*

*a) Makine teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anesor, me kapacitet mbajtes 10-12 ton raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit te prodhimit jo me poshte se 2014 dhe jo me pak se niveli i emetimit te gazeve Euro 6, jo me pak se 2 (dy) cope;*

*b) Makine transportuese, me ngarkim fundor ose anesor, me kapacitet mbajtes jo me pak se 2 ton, jo me pak se 1 (nje) cope;*

c) Makina per Lagien e rrugeve, (autobote) te pajisura me pompe per Lagien e rrugeve me presion, me dy ose me shume pjata larese ne pjesen e perparme, me kapacitet mbajtes jo me pak se 10,000 litra uje jo me pale se 1 (nje) cope; Mjete teknologjike rezerve:

d) Makine teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anesor, me kapacitet mbajtes 8-12 ton raport kompaktimi 1:4 - 1:6 2 (dy) cope;

Per Mjetet teknologjike te kerkuara ne piken 8, germa a - d, operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin si me poshte:

a) Mjetet ne pronesi duhet te shoqerohen me akt pronesie, leje qarkullimi, certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracion te mjetit.

b) Mjetet me qira duhet te shoqerohen me kontrate qiraje si dhe me aktin e pronesise se qiradhenesit (origjinal ose kopje e noterizuar) se bashku me leje qarkullimi, certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracion te mjetit. Kontrata e qirase duhet te permbaje objektin dhe afatin e marrjes me qira te mjeteve (e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi).

c) Operatori ekonomik duhet te paraqese foto per secilin mjet te deklaruar ne pronesi ose me qira, ku te jete e dukshme dhe targa e mjetit.

d) Per mjetet ne pronesi/qira operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate ku autorizon autoritetin kontraktor te kryeje verifikimin fizik te mjeteve sipas Specifikimeve Teknike te deklaruar ne proceduren e prokurimit si dhe te deklaroje adresen e sakte te vendndodhjes se mjeteve me qellim verifikimin e tyre si edhe te deklaroje qe mjetet te mos jene te angazhuara ne kontrata te tjera.

Percaktimi nga ana e autoritetit kontraktor Bashkia Cerrik i vitit te prodhimit jo me poshte se 2014 dhe jo me pak se niveli i emetimit te gazeve Euro 6 te nje makinerie eshte nje kriter diskriminues dhe eshte ne kundërshtim me nenin 1 dhe 2 te LPP-se. Makinerite jane kolauduar nga kompania "SGS Albania" e cila përcakton, se nese makina ploteson kriteret (kontrolli teknik, shkarkimin e gazrave te motorit ne ajer etj.,) sipas legjislacionit ne fuqi per te qarkulluar ne rruget e Republikës se Shqiperise. Kur makinerite kolaudohen ne baze te rregullave te percaktuara ne Manualin e Kontrollit të Mjeteve nga shoqeria "SGS" Albania" atehere keto makineri mund te perdoren ne Republiken e Shqiperise. Vendosja e vitit te prodhimit nga autoriteti kontraktor si kusht skualifikimi eshte nje kriter diskriminues, i pabazuar ne VKM nr. 914, date 29.12.2014 dhe LPP.

Kerkojme heqjen e ketij kriteri per vitin e prodhimit te mjetit jo me pak se viti 2014 dhe jo me pak se niveli i emetimit te gazeve Euro 6.

Verejme se viti i prodhimit eshte kerkuar per nje mjet te vetem, kurse mjetet e tjera te kerkuara ne kete procedure nuk e kane kete percaktim. Bindshem na lind arsytimi i dyshuar qe ky kriter eshte vendosur per te favorizuar fituesin e paracaktuar duke kufizuar keshtu konkurrencen per pjesemarrje dhe duke diskriminuar operoret e tjere ekonomike.

*Ne nenin 46, pika 1 germa "b" te ligjit nr, 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohen dhe jodiskriminuese.*

*b) aftesia teknike: operatoret ekonomike vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, per te zbatuar kontraten, sic eshte pershkruar nga autoriteti kontraktor ne njoftimin e objektit te kontrates;*

*Ndersa ne nenin 53/3 te LPP-se percakohet se: "Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit.."*

*Neni 26, pika 8, e Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 914, date 29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: "Per te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kerkon: a) licensa profesionale te shoqerise per realizimin e punimeve, objekt i kontrates, te leshuara nga autoritetet kompetente shteterore; dhe/ose b) deshmi per fuqine punetore te operatorit ekonomik te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit; dhe/ose c) deshmi per mjetet e pajisjet teknike, qe ka ne dispozicion apo qe mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik per te permbushur kontraten".*

*Referuar Ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 1, pika 2 percaktohet: c) te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik; ç) te nxise konkurrencen ndermjet operatoreve ekonornike;*

*Te njejtin qendrim ka mbajtur Komisioni i Prokurimit Publik ne vendimin Nr.748/2017:*

*Kerkojme modifikimin e kriterit duke hequr vitin e prodhimit te mjeteve dhe paraqitjen e mjeteve me Kontrate Porosie ose blerje me kusht.*

*2. Ne specifikimet teknike AK ka parashikuar qe OE pjesmarres te kene ne dispozicion Makine transportuese te konteniereve me platforme ngarkimi nga pas, per te mundesuar ngarkimin dhe shkarkimin e konteniereve pa sjelle demtimin e tyre, jo me pak se 1 (nje) cope.*

*Kjo makineri nuk eshte vendosur ne kerkesat e vecanta per kualifikim. Kerkojme qe AK te hartoje kriteret ne perputhje me specifikimet teknike duke shtuar mjetin per transportin e kazaneve.*

*3. Ne DST, Kriteret e Vecanta per Kualifikim, Kapaciteti Teknik nen pika 8 kerkohet:*

e) Si mjete dhe pajisje per kryerjen e sherbimit, operatori ekonomik duhet te deshmoje se disponon jo me pak se 300 konteniere me volum 1.1, shoqeruar me akt pronesie, akt zhdoganimi, fature tatimore blerjeje/ose me qira. Ne rast se pajisjet disponohen me qira operatori ekonomik duhet te dorezoje kontraten e qirase te vlefshme per gjate gjithë periudhes se kontrates shoqeruar me aktin e pronesise se qiradhenesit. Kontenieret duhet te permbushin standardet EN 840 dhe RAL ose ekuivalent vertetuar kjo e fundit me certifikate cilesie. Per pajisjet e mesiperme te dorezohen edhe kataloget perkates.

Ne nenin 28, pika 5, germa "c" e Vendimit nr. 914, date 29.12.2014 te Keshillit te Ministrave "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, percaktohet: "Per te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kerkon: ç) deshmi per mjetet dhe pajisjet teknike qe ka ne dispozicion apo qe mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik per te permbushur kontraten".

Kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per te krijuar nje panorame te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesise se operatorit per permbushje me sukses te kontrates, Ne varesi te kontrates dhe volumit te saj autoriteti kontraktor percakton kerkesat e vecanta per kualifikim, te cilat jane te detyrueshme per t'u permbushur nga operatoret ekonomike pjesemarres ne procedurat e prokurimit. Operatoret ekonomike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentet e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumente duhet te refuzohen si te papranueshme.

Nuk kuptojme perse eshte e nevojshme qe operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje paraprakisht 300 konteniere gjendje, kur ne preventivin e Ofertes se publikuar nga ana e autoritetit kontraktor jane parashikuar vetem zerat e meposhtem per t'u ofertuar:

Grumbullim dhe transportim i mbetjeve urbane (Ton/dite).

Grumbullim dhe transportim i mbetjeve rurale (Ton/dite)

Larje dhe dizifektim i konteniereve

Fshirje e rrugeve dhe trotuareve me krahe

Larje e rrugeve nje here ne dite

AK nuk ka kerkuar ne asnje rast se operatori ekonomik do te duhet te kryeje investim edhe per vendosjen e 300 konteniereve te rinj, duke mos llogaritur njeherazi edhe fondin limit per furnizimin edhe me 300 konteniere, por ka llogaritur vetem fondin limit per kryerjen e sherbimit. Edhe ne specifikimet teknike ne asnje rast nuk eshte sqaruar se kontenieret do te jene investim i bere nga shoqeria private.

Akoma me teper ne Specifikimet teknike eshte parashikuar:

Për zonen urbane gjenerimi i mbetjeve do te jetë 10.2 ton në ditë ku për depozitimin e të cilave po referuar shtojces 1 te zbatuar VKM Nr. 319, datë 31.5.2018 "Për Miratimin e Masave Për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, do te duhen 87 kontenierë me volum 1100 litra (1.1 m<sup>3</sup>), dhe ku frekuenca e sherbimit do jete 7 here ne jave per 365 dite ne vit.

*Për zonën rurale gjenerimi i mbetjeve do të jetë 11.66 ton në ditë /ose 40.82 ton/2 here ne jave ku për depozitimin e të cilave po referuar shtojces 1 të zbatuar VKM Nr. 319, datë 31.5.2018 “Për Miratimin e Masave Për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, do të duhen 160 kontenierë me volum 2400 litra (2.4 m<sup>3</sup>) dhe ku frekuenca e shërbimit do të jete 2 here ne jave ose 104 dite ne vit.*

*Për zonën urbane shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve do të jetë 7 here/javë. Ne këtë zonë kontenierët duhet të jenë plastik.*

*Për zonën rurale shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve do të jetë 2 here/javë. Ne këtë zonë kontenierët duhet të jenë metalik ekzistues.*

*Pra  $87+160 = 247$  konteniere, nr me i vogel sesa ai qe eshte kerkuar ne DST. AK duhet te hartojte kriteret ne perputhje me specifikimet teknike, jo duke kerkuar numer me te larte kontenieresh sesa nevojiten sipas llogaritjeve qe vete AK ka kryer.*

*Gjithashtu kërkesa për Kontenieret duhet të përmbushin standardet EN 840 dhe RAL ose ekuivalent vertetuar kjo e fundit me certifikate cilesie. Per pajisjet e mesiperme te dorezohen edhe kataloget perkates, ky eshte nje kriter jo ne porpocion me shërbimin e kerkuar, pasi vete AK ka kerkuar vetem 87 konteniere plastike te cilet kane certifikate per plastiken me standard EN 840 dhe RAL, kurse per kontenieret metalik ekzistues ne zonat rurale ky standard nuk ekziston.*

*Pra nga sa analizuam me siper 300 konteniere nuk jane te nevojshem per kete shërbim dhe kerkojme heqjen e ketij kriteri.*

*Per kontenieret e zonave rurale ne specifikimet teknike AK ka percaktuar volumin 2.4 m<sup>3</sup>. Kerkojme nga AK sqarim se perse nevojiten keta konteniere me kete volum kaq te madh? Mos ndoshta eshte lapsus nga AK dhe volumi i konteniereve duhet te jete 240 litra? Kerkojme nga AK te na vere ne dispozicion nje foto te ketij lloj kontenieri te kerkuar.*

*Te njejtin qendrim ka mbajtur edhe Komisioni i Prokurimit Publik ne vendimin KPP 673/2017.*

*4. Ne DST, Kriteret e Vecanta per Kualifikim, Kapaciteti Teknik nen pika 0 kerkohet:*

*Operatori nga dita e shpalljes se procedures deri ne momentin e hapjes se ofertave duhet te paraqese mostra per artikujt e meposhtem:*

*1 konteniere me volum 1.1 te shoqeruar me kopje te certifikates se cilesise per pëmbushjen e standardeve EN 840 dhe RAL ose ekuivalent.*

*Vendosja e ketij kriteri nga AK cenon fshehtesine e procesit per pjesemarrjen ne procedurat e prokurimit publik. Ky kriter nuk mund te jete kusht per skualifikim, AK mund te kerkoje paraqitjen e monstres per kontenierin 1.1 pas dorezimit te ofertave ne nje date dhe vend te caktuar nga ai. Kerkojme nga AK heqjen e ketij kriteri nga kriteret e vecanta per kualifikim.*

*Kerkojme pranimin e ankeses dhe modifikim e kriterve te vecanta per kualifikim si me siper te argumentuara dhe te mbeshtetura ne prova dhe ligj.*

II.2.1. Në datë 10.02.2021 me shkresën nr 534/1 prot, pala ankimuese operatori ekonomik “Rej” ShPK ka marrë dijeni në lidhje me pranimin pjesërisht të ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor:

*Per sa i perket pikes se pare te ankeses: Leje mjedisore e leshuar nga Qendra Kombetare e licensimit per veprimtari qe kane ndikim ndaj mjedisit (stacion transferimi per mbetje jo te rrezikshme), (Kodi III 1.A). Bazuar ne ligjin nr.52/2020 Per disa ndryshme ne ligjin nr 10448, date 14.07.2011, “Per lejet e mjedisit”, i ndryshuar.*

*Komisioni i shqyrtimit te ankeses vlereson se., nenin 11, te ligjit Nr. 52/2020, ku percaktohet se: “Pas hyrjes ne fuqi te ligjit, cdo parashishikim per lejet e mjedisit te tipit C ne ligjin nr. 162/2014, “Per mbrojtjen e cilesise se ajrit ne mjedis” dhe cdo dispozite tjeter ligjore qe vjen ne kundershtrim me dispozitat e ketij ligji, shfuqizohen”.*

*Per sa me siper vleresojme se kjo pike e ankeses pranohet.*

*Pika e dyte e ankeses: Ankimuesi pretendon se kerkesa se operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate me shkrim mbi disponueshmerine e mjeteve, ka percaktuar te dhenat teknike dhe sasite percaktuese per mjetet e meposhtme:*

*a) Makine teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anesor; me kapacitet mbajtes 10-12 ton raport kompaktimi 1:4, - 1:6;, vitit te prodhimit jo me poshte se 2014 dhe jo me pak se niveli i emetimit te gazeve Euro 6, jo me pak se 2 (dy) cope;*

*b) Makine transportuese, me ngarkim fundor ose anesor, me kapacitet mbajtes jo me pak se 2 ton, jo me pak se 1 (nje) cope;*

*Persa i perket ankeses se OE per sa me siper vleresojme se kjo pike e ankeses pranohet pjeserisht duke kerkuar ndryshimin e kerkeses:*

*Nga:*

*Makine teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anesor; me kapacitet mbajtes 10-12 ton raport kompaktimi 1:4, - 1:6;, vitit te prodhimit jo me poshte se 2014 dhe jo me pak se niveli i emetimit te gazeve Euro 6, jo me pak se 2 (dy) cope;*

*Ne:*

*Makine teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anesor; me kapacitet mbajtes 10-12 ton raport kompaktimi 1:4, - 1:6;, vitit te prodhimit jo me poshte se 2013 dhe jo me pak se niveli i emetimit te gazeve Euro 6, jo me pak se 2 (dy) cope;*

*Persa i perket pikes se trete te ankeses: Ankimuesi pretendon se: per kapacitetin teknik nen pika 8 kerkohet:*



- a) *Si mjete dhe pajisje per kryerjen e sherbimit operatori ekonomik duhet te deshmoje se disponon jo me pak se 300 konteniere me volum 1:1 shoqeruar me akt pronesie – akt pronesie, akt zhdoganimi, fature tatimore blerjeje ose me qira. Ne rast se pajisjet disponohen me qira operatori ekonomik duhet te dorezoje kontraten e qirase te vlefshme pergjate gjithë periudhen e kontrates shoqeruar me aktin pronesise te qiradhenesit. Kontenieret duhet te permbushin standardin EN 840 dhe RAL ose ekuivalent vertetuar kjo e fundit me certifikate cilesise. Per pajisjet e mesiperme te dorezohen edhe kataloget perkates.*

*Komisioni i shqyrtimi te ankeses vlereson se:*

*Te shtojca e specifikimeve teknike, AK ka percaktuar qe “Per zonat urbane gjenerimi i mbetjeve do te jete 10.2 ton ne dite ku per depozitim e te cilave po referuar shtojces 1 ne zbatim te VKM nr. 319, date 31.05.2018 “Per miratimin e masave per kostot e menaxhimit te integruar te mbetjeve do te duhen 87 kontenjere me volum 1100 litra 1.1 m<sup>3</sup>, dhe ku frekuenca e sherbimit do te jete 7 here ne jave per 365 dite ne vit.*

*Per sa me lart pranohet pjeserisht ankesa duke vendosur:*

*Nga:*

- a) *Si mjete dhe pajisje per kryerjen e sherbimit operatori ekonomik duhet te deshmoje se disponon jo me pak se 300 konteniere me volum 1:1 shoqeruar me akt pronesie – akt pronesie, akt zhdoganimi, fature tatimore blerjeje ose me qira. Ne rast se pajisjet disponohen me qira operatori ekonomik duhet te dorezoje kontraten e qirase te vlefshme pergjate gjithë periudhen e kontrates shoqeruar me aktin pronesise se qiradhenesit. Kontenieret duhet te permbushin standardin EN 840 dhe RAL ose ekuivalent vertetuar kjo e fundit me certifikate cilesise. Per pajisjet e mesiperme te dorezohen edhe kataloget perkates.*

*Në:*

- a) *Si mjete dhe pajisje per kryerjen e sherbimit operatori ekonomik duhet te deshmoje se disponon jo me pak se 87 konteniere me volum 1:1 shoqeruar me akt pronesie – akt pronesie, akt zhdoganimi, fature tatimore blerjeje ose me qira. Ne rast se pajisjet disponohen me qira operatori ekonomik duhet te dorezoje kontraten e qirase te vlefshme pergjate gjithë periudhen e kontrates shoqeruar me aktin pronesise te qiradhenesit. Kontenieret duhet te permbushin standardin EN 840 dhe RAL ose ekuivalent vertetuar kjo e fundit me certifikate cilesise. Per pajisjet e mesiperme te dorezohen edhe kataloget perkates.*

*Persa i perket pikes se katert te ankeses Ankimuesi pretendon se ne DST kriteret e vecanta per kualifikim kapaciteti teknik nen pika 10 kerkohet:*

*Operatori nga dita e shpalljes se procedures deri ne momentin e hapjes se ofertave duhet te paraqese mostra per artikujt e meposhtem.*

a. 1 konteniere me volum 1.1 te shoqeruar me kopje te certifikates se cilesise per pembushjen e standardeve EN 840 dhe RAL ose ekuivalent.

Vendosja e ketij kriteri nga Ak cenon fshehtesine e procesit per pjesemarrje ne procedurat e Prokurimit Publik. Ky kriter nuk mund te jete kusht per skualifikim, Ak mund te kerkoje paraqitjen e mostres per kontenierin 1.1 pas dorezimit te ofertave ne nje date dhe vend te caktuar nga ai. Kerkojme nga AK heqjen e ketij kriteri nga kriteret e vecanta per kualifikim.

Persa i perket ankeses se OE per sa me siper vleresojme se kjo pike e ankeses nuk pranohet.

II.2.2. Në datën 17.02.2021 operatori ekonomik “Rej” ShPK ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e ngritur pranë autoritetit kontraktor.

II.3. Me shkresën me nr. 773/1 prot, datë 26.02.2021, protokolluar me tonën me nr. 259/2 prot, datë 03.03.2021, me objekt “Informacion” është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Rej” sh.p.k. për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit, sipas argumentimit si më poshtë vijon: “Në DST, Kriteret e Veçanta për Kualifikim, Kapaciteti Teknik pika 7 kërkohet: Leje Mjedisore të leshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për veprimtari që kanë ndikim ndaj mjedisit (Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme), (Kodi III.1.A) Bazuar në ligjin Nr. 52/2020 PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10448, DATË 14.7.2011, “PËR LEJET E MJEDISIT”, TË NDRYSHUAR Neni 11 Shfuqizime. Pas hyrjes në fuqi të ligjit, çdo parashikim për lejet e mjedisit të tipit C, në ligjin nr. 162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis” dhe çdo dispozitë tjetër ligjore, që vjen në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, shfuqizohen. Termi III.1.A ligjërish i referohet lejes C, bazuar në ligjin nr 52/2020 për disa ndryshime në ligjin Nr.10448, datë 14/07/2011 “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, Leja C nuk ekziston më dhe në këto kushte AK nuk mund të kërkojë një dokument i cili është shfuqizuar. Në nenin 46, pika 1 gërma “a” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe

*jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licensat profesionale industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata; Kërkojmë të hiqet ky kriter nga kërkesat e veçanta për kualifikim si një kriter i pabazuar në Ligj.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 3.3.7, të dokumenteve të tenderit, të publikuara në datën 02.02.2021, nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesave si më poshtë vijon::

7. *“Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur nga Qendra Kombëtare e Licensimit me;*
- *Leje Mjedisore të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për veprimtari që kanë ndikim ndaj mjedisit (Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme), (Kodi III.1.A)*
  - *Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (kodi III.2.B) “ Grumbullim, transportim dhe përpunim i mbetjeve urbane”.*

III.1.2. Në datën 17.02.2021 autoriteti kontraktor ka publikuar një shtojcë në sistemin elektronik të prokurimeve, duke bërë modifikimin e kriterit të mësipërm si vijon:

*Ishte:*

*“Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur nga Qendra Kombëtare e Licensimit me;*

- *Leje Mjedisore të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për veprimtari që kanë ndikim ndaj mjedisit (Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme), (Kodi III.1.A)*
- *Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (kodi III.2.B) “ Grumbullim, transportim dhe përpunim i mbetjeve urbane”.*

*Bëhet:*

*Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur nga Qendra Kombëtare e Licensimit me;*

- *Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (kodi III.2.B) “ Grumbullim, transportim dhe përpunim i mbetjeve urbane”*

III.1.3. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, si dhe kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar operatorit ekonomik ankimues me shkresën nr 534/1 prot datë 10.02.2021, arsyetohet si më poshtë:

*“[...]Për sa i përket pikës së parë të ankesës: Leje mjedisore e lëshuar nga Qendra Kombëtare e licensimit për veprimtari që kanë ndikim ndaj mjedisit (stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme), (Kodi III 1.A). Bazuar në ligjin nr.52/2020 Për disa ndryshime në ligjin nr 10448, datë 14.07.2011, “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar.*

*Komisioni i shqyrtimit të ankesës vlerëson se, bazuar në nenin 11, të ligjit Nr. 52/2020, ku përcaktohet se: “Pas hyrjes në fuqi të ligjit, çdo parashikim për lejet e mjedisit të tipit C në*

ligjin nr. 162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis” dhe çdo dispozitë tjetër ligjore që vjen në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, shfuqizohen”.

*Për sa më sipër vlerësojmë se kjo pikë e ankesës pranohet. [...].*

III.1.4. Referuar sa më sipër lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit të sipërpërmendur, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se pretendimet e operatorit ekonomik “Rej” ShPK janë pranuar nga autoriteti kontraktor duke përmbushur kështu interesin dhe qëllimin e ankimuesit në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Në këtë kuptim KPP nuk shprehet më tej lidhur me pretendimet e ankimuesit të parashtruara në ankesë pasi nuk ka më objekt ankimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk merret në shqyrtim.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Rej” shpk për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit, sipas argumentimit si më poshtë vijon: “*Ne DST, Kriteret e Vecanta per Kualiflkim, Kapaciteti Teknik nen pika 8 kerkohet: e) Si mjete dhe pajisje per kryerjen e sherbimit, operatori ekonomik duhet te deshmoje se disponon jo me pak se 300 konteniere me volum 1.1, shoqeruar me akt pronesie, akt zhdoganimi, fature tatimore blerje/ose me qira. Ne rast se paisjet disponohen me qira operatori ekonomik duhet te dorezoje kontraten e qirase te vlefshme pergjate gjithe periudhes se kontrates shoqeruar me aktin e pronesise se qiradhenesit. Kontenieret duhet te permbushin standardet EN 840 dhe RAL ose ekuivalent vertetuar kjo e fundit me certifikate cilesie. Per pajisjet e mesiperme te dorezohen edhe kataloget perkates. Ne nenin 28, pika 5, germa “c” e Vendimit nr. 914, date 29.12.2014 te Keshillit te Ministrave “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, percaktohet: “Per te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kerkon: ç) deshmi per mjetet dhe pajisjet teknike qe ka ne dispozicion apo qe mund t’i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik per te permbushur kontraten”. Kriteret per kualifikim vendosen qe t’i sherbejne autoritetit kontraktor per te krijuar nje panorame te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesise se operatorit per permbushje me sukses te kontrates, Ne varesi te kontrates dhe volumit te saj autoriteti kontraktor percakton kerkesat e vecanta per kualifikim, te cilat jane te detyrueshme per t’u permbushur nga operoret ekonomike pjesemarres ne procedurat e prokurimit. Operoret ekonomike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentet e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumente duhet te refuzohen si te papranueshme. Nuk kuptojme perse eshte e nevojshme qe operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje paraprakisht 300 konteniere gjendje, kur ne preventivin e Ofertes se publikuar nga ana e autoritetit kontraktor jane parashikuar vetem zerat e meposhtem per t’u ofertuar: Grumbullim dhe transportim i mbetjeve urbane (Ton/dite). Grumbullim dhe transportim i mbetjeve rurale (Ton/dite). Larje dhe dizifektim i konteniereve. Fshirje e rrugeve dhe trotuareve me krahe. Larje e rrugeve nje here ne dite. AK nuk ka kerkuar ne asnje rast se operatori ekonomik do te duhet te kryeje investim edhe per vendosjen e 300 konteniereve te rinj, duke mos llogaritur njeherazi edhe fondin limit per furnizimin edhe me 300 konteniere, por ka llogaritur vetem fondi limit per kryerjen e sherbimit. Edhe ne specifikimet teknike ne asnje rast nuk eshte sqaruar se kontenieret do te jene investim i bere nga shoqeria private.*

Akoma me teper ne Specifikimet teknike eshte parashikuar: Për zonen urbane gjenerimi i mbetjeve do te jetë 10.2 ton në ditë ku për depozitimin e të cilave po referuar shtojces 1 te zbatua VKM Nr. 319, datë 31.5.2018 “Për Miratimin e Masave Për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, do te duhen 87 konteinerë konteinerëve me volum 1100 litra (1.1 m<sup>3</sup>), dhe ku frekuenca e shërbimit do jete 7 here ne jave per 365 dite ne vit. Për zonën rurale gjenerimi i mbetjeve do te jetë 11.66 ton në ditë /ose 40.82 ton/2 here ne jave ku për depozitimin e të cilave po referuar shtojces 1 te zbatuar VKM Nr. 319, datë 31.5.2018 “Për Miratimin e Masave Për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, do te duhen 160 konteinerë me volum 2400 litra (2.4 m<sup>3</sup>) dhe ku frekuenca e shërbimit do jete 2 here ne jave ose 104 dite ne vit. Për zonën urbane shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve do të jetë 7 here/javë. Ne këtë zonë konteinerët duhet të jenë plastik. Për zonën rurale shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve do të jetë 2 here/javë. Ne këtë zonë konteinerët duhet të jenë metalike ekzistues. Pra 87+160 = 247 konteinerë, nr me i vogel sesa ai qe eshte kerkuar ne DST. AK duhet te hartoje kriteret ne perputhje me specifikimet teknike, jo duke kerkuar numer me te larte konteineresh sesa nevojiten sipas llogaritjeve qe vete AK ka kryer. Gjithashtu kerkesat per konteineret duhet te permbushin standardet EN 840 dhe RAL ose ekuivalent vertetuar kjo e fundit me certifikate cilesie. Per pajisjet e mesiperme te dorezohen edhe kataloget perkates, ky eshte nje kriter jo ne porpocion me shërbimin e kerkuar, pasi vete AK ka kerkuar vetem 87 konteinerë plastike te cilet kane certifikate per plastikën me standard EN 840 dhe RAL kurse per konteineret metalik ekzistues ne zonat rurale ky standard nuk ekziston. Pra nga sa analizuam me siper 300 konteinerë nuk jane te nevojshem per kete shërbim dhe kerkojme heqjen e këtij kriteri. Per konteineret e zonave rurale ne specifikimet teknike AK ka percaktuar volumin 2.4 m<sup>3</sup>. Kerkojme nga AK sqarim se perse nevojiten keta konteinerë me kete volum kaq te madh? Mos ndoshta eshte lapsus nga AK dhe volumi i konteinerëve duhet te jete 240 litra? Kerkojme nga AK te na vere ne dispozicion nje foto te ketij lloj konteineri te kerkuar. Te njejtin qendrim ka mbajtur edhe Komisioni i Prokurimit Publik ne vendimin KPP 673/2017.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 3.3.7, të dokumenteve të tenderit, të publikuara në datën 02.02.2021, nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesave si më poshtë vijon::

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:

- a) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës **10-12 ton** raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2014 dhe jo më pak se niveli i emetimit të gazeve Euro 6, jo më pak se **2 (dy) copë**;
- b) Makinë transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 2 ton, jo më pak se **1 (nje) copë**;
- c) Makina për Lagien e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për Lagien e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10,000 litra ujë jo më pak se **1 (një) copë**;

*Mjete teknologjike rezervë:*

- d) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës **8-12 ton** raport kompaktimi 1:4 - 1:6 **2 (dy) copë**;*

*Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 8, gërma a – d, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:*

- a) Mjetet në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie, leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracion të mjetit.*
- b) Mjetet me qira duhet të shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje e noterizuar) së bashku me leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracion të mjetit. Kontrata e qirasë duhet të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qira të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi).*
- c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- d) Për mjetet në pronësi/qira operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku autorizon autoritetin kontraktor të kryejë verifikimin fizik të mjeteve sipas Specifikimeve Teknike të deklaruara në procedurën e prokurimit si dhe të deklarojë adresën e sakte të vendndodhjes së mjeteve me qëllim verifikimin e tyre si edhe të deklarojë që mjetet të mos jenë të angazhuara në kontrata të tjera.*
- e) Si mjete dhe pajisje për kryerjen e shërbimit, operatori ekonomik duhet të dëshmojë se disponon jo më pak se 300 kontenierë me volum 1.1, shoqëruar me akt pronësie, akt zhdoganimi, faturë tatimore blerjeje/ose me qira. Në rast se pajisjet disponohen me qira operatori ekonomik duhet të dorëzojë kontratën e qirasë të vlefshme përgjatë gjithë periudhës së kontratës shoqëruar me aktin e pronësisë së qiradhënësit. Kontenierët duhet të përmbushin standardet EN 840 dhe RAL ose ekuivalent vërtetuar kjo e fundit me certifikatë cilësie. Për pajisjet e mësipërme të dorëzohen edhe katalogët përkatës.*

III.2.2. Në datën 17.02.2021 autoriteti kontraktor ka publikuar një shtojcë në sistemin elektronik të prokurimeve, duke bërë modifikimin e kriterit të mësipërm si vijon:

*Ishte:*

*Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:*

- e) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës **10-12 ton** raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2014 dhe jo më pak se niveli i emetimit të gazeve Euro 6, jo më pak se **2 (dy) copë**;*
- f) Makinë transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 2 ton, jo më pak se **1 (një) copë**;*

- g) Makina për Lagien e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për Lagien e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10,000 litra ujë jo më pak se 1 (një) copë;**

*Mjete teknologjike rezervë:*

- h) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 8-12 ton raport kompaktimi 1:4 - 1:6 2 (dy) copë;**

*Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 8, gërma a – d, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:*

- f) Mjetet në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie, leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracion të mjetit.**
- g) Mjetet me qira duhet të shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje e noterizuar) së bashku me leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracion të mjetit. Kontrata e qirasë duhet të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qera të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi).**
- h) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.**
- i) Për mjetet në pronësi/qira operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku autorizon autoritetin kontraktor të kryejë verifikimin fizik të mjeteve sipas Specifikimeve Teknike të deklaruara në procedurën e prokurimit si dhe të deklarojë adresën e sakte të vendndodhjes së mjeteve me qëllim verifikimin e tyre si edhe të deklarojë që mjetet të mos jenë të angazhuara në kontrata të tjera.**
- j) Si mjete dhe pajisje për kryerjen e shërbimit, operatori ekonomik duhet të dëshmojë se disponon jo më pak se 300 kontenierë me volum 1.1, shoqëruar me akt pronësie, akt zhdoganimi, faturë tatimore blerjeje/ose me qira. Në rast se pajisjet disponohen me qira operatori ekonomik duhet të dorëzojë kontratën e qirasë të vlefshme përgjatë gjithë periudhës së kontratës shoqëruar me aktin e pronësisë së qiradhënësit. Kontenierët duhet të përmbushin standardet EN 840 dhe RAL ose ekuivalent vërtetuar kjo e fundit me certifikatë cilësie. Për paisjet e mësiëprme të dorëzohen edhe katalogët përkatës.**

*Bëhet:*

*Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:*

- a) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10-12 ton raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2013 dhe jo më pak se niveli i emetimit të gazeve Euro 6, jo më pak se 2 (dy) copë;**
- b) Makinë transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 2 ton, jo më pak se 1 (një) copë;**
- c) Makina për Lagien e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për Lagien e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10,000 litra ujë jo më pak se 1 (një) copë;**

*Mjete teknologjike rezervë:*

- d) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 8-12 ton raport kompaktimi 1:4 - 1:6 2 (dy) copë;*

*Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 8, gërma a – d, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:*

- a) Mjetet në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie, leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracion të mjetit.*
- b) Mjetet me qira duhet të shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje e noterizuar) së bashku me leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracion të mjetit. Kontrata e qirasë duhet të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qira të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi).*
- c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- d) Për mjetet në pronësi/qira operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku autorizon autoritetin kontraktor të kryejë verifikimin fizik të mjeteve sipas Specifikimeve Teknike të deklaruara në procedurën e prokurimit si dhe të deklarojë adresën e sakte të vendndodhjes së mjeteve me qëllim verifikimin e tyre si edhe të deklarojë që mjetet të mos jenë të angazhuara në kontrata të tjera.*
- e) Si mjete dhe pajisje për kryerjen e shërbimit, operatori ekonomik duhet të dëshmojë se disponon jo më pak se 87 kontenierë me volum 1.1, shoqëruar me akt pronësie, akt zhdoganimi, faturë tatimore blerjeje/ose me qira. Në rast se pajisjet disponohen me qira operatori ekonomik duhet të dorëzojë kontratën e qirasë të vlefshme përgjatë gjithë periudhës së kontratës shoqëruar me aktin e pronësisë të qiradhënësit. Kontenierët duhet të përmbushin standardet EN 840 dhe RAL ose SSH ose ekuivalent vërtetuar kjo e fundit me certifikatë cilësie. Për pajisjet e mësipërme të dorëzohen edhe katalogët përkatës.*

III.2.3. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, si dhe kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar operatorit ekonomik ankimes me shkresën nr 534/1 prot datë 10.02.2021, arsyetohet si më poshtë:

*“[...]Për sa i përket pikës së tretë të ankesës: Ankimesi pretendon se për kapacitetin teknik nën pika 8 kërkohet: Si mjete dhe pajisje për kryerjen e shërbimit operatori ekonomik duhet të dëshmojë se disponon jo më pak se 300 kontenierë me volum 1:1 shoqëruar me akt pronësie, akt zhdoganimi, faturë tatimore blerjeje ose me qira. Në rast se pajisjet disponohen me qira operatori ekonomik duhet të dorëzojë kontratën e qirasë të vlefshme përgjatë gjithë periudhën e kontratës shoqëruar me aktin e pronësisë së qiradhënësit. Kontenierët duhet të përmbushin standardin EN 840 dhe RAL ose ekuivalent vërtetuar kjo e fundit me certifikatë cilësie. Për pajisjet e mësipërme të dorëzohen edhe katalogët përkatës. Komisioni i shqyrtimit të ankesës vlerëson se: Te shtojca e specifikimeve teknike, AK ka përcaktuar që “Për zonat urbane*



gjenerimi i mbetjeve do të jetë 10.2 ton në ditë ku për depozitimin e të cilave po referuar shtojcës 1 në zbatim të VKM nr. 319, datë 31.05.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve do të duhen 87 kontenierë me volum 1100 litra 1.1 m3, dhe ku frekuenca e shërbimit do të jetë 7 herë në javë për 365 ditë në vit. Për sa më lart pranohet pjesërisht ankesa duke vendosur **Nga:** Si mjete dhe pajisje për kryerjen e shërbimit operatori ekonomik duhet të dëshmojë se disponon jo më pak se 300 kontenierë me volum 1:1 shoqëruar me akt pronësie, akt zhdoganimi, faturë tatimore blerjeje ose me qira. Në rast se pajisjet disponohen me qira operatori ekonomik duhet të dorëzojë kontratën e qirasë të vlefshme përgjatë gjithë periudhën e kontratës shoqëruar me aktin e pronësisë së qiradhënësit. Kontenierët duhet të përmbushin standardin EN 840 dhe RAL ose ekuivalent vërtetuar kjo e fundit me certifikatën e cilësisë. Për pajisjet e mësipërme të dorëzohen edhe katalogët përkatës. **Në:** Si mjete dhe pajisje për kryerjen e shërbimit operatori ekonomik duhet të dëshmojë se disponon jo më pak se 87 kontenierë me volum 1:1 shoqëruar me akt pronësie, akt zhdoganimi, faturë tatimore blerjeje ose me qira. Në rast se pajisjet disponohen me qira operatori ekonomik duhet të dorëzojë kontratën e qirasë të vlefshme përgjatë gjithë periudhën e kontratës shoqëruar me aktin e pronësisë së qiradhënësit. Kontenierët duhet të përmbushin standardin EN 840 dhe RAL ose ekuivalent vërtetuar kjo e fundit me certifikatën e cilësisë. Për pajisjet e mësipërme të dorëzohen edhe katalogët përkatës.”. Për sa më sipër vlerësojmë se kjo pikë e ankesës pranohet. [...].

III.2.4. Referuar sa më sipër lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit të sipërpërmëndur, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se pretendimet operatorit ekonomik “Rej” shpk janë pranuar nga autoriteti kontraktor duke përmbushur kështu interesin dhe qëllimin e ankimuesit në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Në këtë kuptim KPP nuk shprehet më tej lidhur me pretendimet e ankimuesit të parashtruara në ankesë pasi nuk ka më objekt ankimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk merret në shqyrtim.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Rej” shpk për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit, me argumentin si më poshtë vijon: “2. Në specifikimet teknike AK ka parashikuar që OE pjesëmarrës të kenë në dispozicion Makinë transportuese të kontenierëve me platforme ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, jo më pak se 1 (një) copë. Kjo makineri nuk është vendosur në kërkesat e veçanta për kualifikim. Kërkojmë që AK të hartojë kriteret në përputhje me specifikimet teknike duke shtuar mjetin për transportin e kazanëve. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1 Në dokumentet e tenderit, shtojca 8/2, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, në pikën 8 “Kapaciteti teknik” nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar si më poshtë:

*Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:*

- a) *Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10-12 ton raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2014 dhe jo më pak se niveli i emetimit të gazeve Euro 6, jo më pak se 2 (dy) copë;*
- b) *Makinë transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 2 ton, jo më pak se 1 (një) copë;*
- c) *Makina për Lagien e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për Lagien e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10,000 litra ujë jo më pak se 1 (një) copë;*

*Mjete teknologjike rezervë:*

- d) *Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 8-12 ton raport kompaktimi 1:4 - 1:6 2 (dy) copë;*

*Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 8, gërma a – d, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:*

- k) *Mjetet në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie, leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracion të mjetit.*
- l) *Mjetet me qira duhet të shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje e noterizuar) së bashku me leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracion të mjetit. Kontrata e qirasë duhet të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qira të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi).*
- m) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- n) *Për mjetet në pronësi/qira operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku autorizon autoritetin kontraktor të kryejë verifikimin fizik të mjeteve sipas Specifikimeve Teknike të deklaruara në procedurën e prokurimit si dhe të deklarojë adresën e sakte të vendndodhjes së mjeteve me qëllim verifikimin e tyre si edhe të deklarojë që mjetet të mos jenë të angazhuara në kontrata të tjera.*
- o) *Si mjete dhe pajisje për kryerjen e shërbimit, operatori ekonomik duhet të dëshmojë se disponon jo më pak se 300 kontenierë me volum 1.1, shoqëruar me akt pronësie, akt zhdoganimi, faturë tatimore blerjeje/ose me qira. Në rast se pajisjet disponohen me qira operatori ekonomik duhet të dorëzojë kontratën e qirasë të vlefshme përgjatë gjithë periudhës së kontratës shoqëruar me aktin e pronësisë të qiradhënësit. Kontenierët duhet të përmbushin standardet EN 840 dhe RAL ose ekuivalent vërtetuar kjo e fundit me certifikatë cilësie. Për pajisjet e mësipërme të dorëzohen edhe katalogët përkatës.*

III.3.2. Në sistemin e prokurimeve elektronike nga autoriteti kontraktor krahas dokumenteve të tenderit ka publikuar edhe specifikimet teknike, të procedurës së tenderit me përcaktimet si më poshtë vijon:

*Mjetet dhe pajisjet:*

- *Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, jo më pak se 1 (një) copë.*
- *Lëndë dezinfektuese dhe aromatizuese (dezinfektues kimik) për dezinfektimin e kontenierëve.*

III.3.3. Në kthim përgjigjen nr. 534/1 prot., datë 10.02.2021, drejtuar operatorit ekonomik ankimues “Rej” ShPK autoriteti kontaktor shprehet se:

*[...] “Përsa i përket pretendimit të OE për mjetin makinë transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimet e tyre, jo më pak se 1 (një) copë. Ky mjet gjendet tek kërkesat e kualifikimit përkatësisht në seksionin 8/b.” [...].*

III.3.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të paraparë nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike (*neni 19/1 e vijues i LPP-së*) dhe autoriteteve kontraktore si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit ( *neni 12 i LPP-së*) dhe njëherazi përgjegjës për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik. Në nenin 63 pika 1.1. të LPP-së, parashikohet se “*Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik.*” KPP gjykon se, që të justifikohet ligjërisht kërkimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar duhet që të bëhet vetëm prej atij që i përket sipas ligjit, e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuesin (*legjitimimi pasiv*), duke justifikuar me këtë fakt ose veprim ndërhyrjen e organit administrativ për të ndaluar ose për të zhdukur dëmin e rrjedhur nga ky fakt, ose veprimeve (*legitimation ad causam*), pra operatori ekonomik ankimues duhet të provojë se interesi i tij i ligjshëm është cënuar nga vendime dhe veprime konkrete (*reale*) të autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar mekanizmat ligjorë për kundërshtimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit pranë këtij të fundit, duke iu dhënë garanci të plota operatorëve ekonomikë ankimues se procedurave për fitimin e kontratave publike, do ti nënshtrohet kushteve specifike (*kriterëve të veçanta të kualifikimit*), të cilat duhet të përmbushin parakushtin si ne qua non të parashikuar nga neni 46 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, të ndryshuar, duke qenë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese. Në rastin konkret, KPP gjykon se njësia e prokurimit pranë autoritetit kontraktor ka parashikuar kriteret minimale kualifikuese, të gjykuar të nevojshëm për vërtetimin e plotësimit të kapacitetit teknik të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Kuadri ligjor në fuqi, ka paraparë pozitën juridike të Komisionit të Prokurimit Publik, si organ i shqyrtimit të ankesave kundër vendimeve të shprehura me akte administrative (*dokumentet e*

*procedurës së prokurimit*) duke i dhënë të drejtën ligjore të shprehet mbi kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike në rast se këto të fundit janë hartuar në përputhje me ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, të ndryshuar dhe kuadrin ligjor në fuqi që rregullon kontratën objekt prokurimi. Kompetenca e mësipërme është shprehur në disa drejtime në ligjin për prokurimin publik në fuqi, ku në nenin 63 pika 4 gërma “b” të lex specialis parashikohet se ndër kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik janë ato të *anulimit, plotësisht ose pjesërisht, një veprimi ose vendimi të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin*. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato kriteret kualifikimi apo specifikime teknike që bien ndesh me këtë ligj. Në rastin konkret, KPP gjykon se në specifikimet teknike është kërkuar “*Makine transportuese e kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, jo më pak se 1 (një) copë*”. Sa i takon kërkesës së ankimuesit, në të cilën pretendon që ky kriter kualifikimi të parashikohet nga ana e autoritetit kontraktor në kriteret e veçanta për kualifikim dhe jo tek specifikimet, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se kjo kërkesë në thelb ka të bëjë me shtim kriteri. Në këtë kuptim, KPP gjykon se, në asnjë rast nuk mund të marrë kompetencat e autoritetit kontraktor (*njësisë së prokurimit*) të shtojë kriteret të tjera kualifikuese për marrjen pjesë në procedurat e prokurimit publik. KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret minimale kualifikuese në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit, (*vetëm kriteret e shprehura dhe jo ato hipotetike të kërkuara*) nuk janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia procedurale e paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik. KPP në asnjë rast nuk mund të marrë kompetencat e autoritetit kontraktor (njësisë së prokurimit) të shtojë kriteret të tjera kualifikuese për marrjen pjesë në procedurat e prokurimit publik.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues se: “*Në DST, Kriteret e Vecanta per Kualifikim, Kapaciteti Teknik pika 8 kerkohe: Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate me shkrim mbi disponueshmerine e mjeteve, ku te percaktohen te dhenat teknike dhe sasite perkatese per mjetet e meposhtme: a) Makine teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anesor, me kapacitet mbajtes 10-12 ton raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit te prodhimit jo me poshte se 2014 dhe jo me pak se niveli i emetimit te gazeve Euro 6, jo me pak se 2 (dy) cope; b) Makine transportuese, me ngarkim fundor ose anesor, me kapacitet mbajtes jo me pak se 2 ton, jo me pak se 1 (nje) cope; c) Makina per Lagien e rrugeve, (autobote) te pajisura me pompe per Lagien e rrugeve me presion, me dy ose me shume pjata larese ne pjesen e perparme, me kapacitet mbajtes jo me pak se 10,000 litra uje jo me pale se 1 (nje) cope; Mjete teknologjike rezerve: d) Makine teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anesor, me kapacitet mbajtes 8-12 ton raport kompaktimi 1:4 - 1:6 2 (dy) cope; Per Mjetet teknologjike te kerkuara ne piken 8, germa a - d, operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin si me poshte: a) Mjetet ne pronesi duhet te shoqerohen me akt pronesie, leje qarkullimi, certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracion te mjetit: b) Mjetet me qira duhet te shoqerohen me kontrate qiraje si dhe me aktin e pronesise se qiradhenesit (origjinal ose kopje e noterizuar) se bashku me leje qarkullimi, certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracion te*

mjetit. Kontrata e qirase duhet te permbaje objektin dhe afatin e marrjes me qira te mjeteve (e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi). c) Operatori ekonomik duhet te paraqese foto per secilin mjet te deklaruar ne pronesi ose me qira, ku te jete e dukshme dhe targa e mjetit. d) Per mjetet ne pronesi/qira operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate ku autorizon autoritetin kontraktor te kryeje verifikimin fizik te mjeteve sipas Specifikimeve Teknike te deklaruar ne proceduren e prokurimit si dhe te deklaroje adresen e sakte te vendndodhjes se mjeteve me qellim verifikimin e tyre si edhe te deklaroje qe mjetet te mos jene te angazhuara ne kontrata te tjera. Percaktimi nga ana e autoritetit kontraktor Bashkia Cerrik i vitit te prodhimit jo me poshte se 2014 dhe jo me pak se niveli i emetimit te gazeve Euro 6 te nje makinerie eshte nje kriter diskriminues dhe eshte ne kundërshtim me nenin 1 dhe 2 te LPP-se. Makinerite jane kolauduar nga kompania "SGS Albania" e cila përcakton: Nese makina ploteson kriteret (kontrolli teknik, shkarkimin e gazrave te motorit ne ajer etj.,) sipas legjislacionit ne fuqi per te qarkulluar ne rruget e Republikës se Shqiperise. Kur makinerite kolaudohen ne baze te rregullave te percaktuara ne Manualin e Kontrollit të Mjeteve nga shoqeria "SGS" Albania" atehere keto makineri mund te perdoren ne Republikën e Shqiperise. Vendosja e vitit te prodhimit nga autoriteti kontraktor si kusht skualifikimi eshte nje kriter diskriminues, i pabazuar ne VKM nr. 914, date 29.12.2014 dhe LPP. Kerkojme heqjen e ketij kriteri per vitin e prodhimit te mjetit jo me pak se viti 2014 dhe jo me pak se niveli i emetimit te gazeve Euro 6. Verejme se viti i prodhimit eshte kerkuar per nje mjet te vetem, kurse mjetet e tjera te kerkuara ne kete procedure nuk e kane kete percaktim. Bindshem na lind arsytimi i dyshuar qe ky kriter eshte vendosur per te favorizuar fituesin e paracaktuar duke kufizuar keshtu konkurrencen per pjesemarrje dhe duke diskriminuar operatorët e tjere ekonomike. Ne nenin 46, pika 1 germa "b" te ligjit nr, 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftesia teknike: operatorët ekonomike vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, per te zbatuar kontraten, sic eshte pershkruar nga autoriteti kontraktor ne njoftimin e objektit te kontrates; Ndersa ne nenin 53/3 te LPP-se percakohet se: "Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit..". Neni 26, pika 8, e Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 914, date 29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: "Per te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kerkon: a) licensa profesionale te shoqerise per realizimin e punimeve, objekt i kontrates, te leshuara nga autoritetet kompetente shteterore; dhe/ose b) deshmi per fuqine punetore te operatorit ekonomik te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit; dhe/ose c) deshmi per mjetet e pajisjet teknike, qe ka ne dispozicion apo qe mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik per te permbushur kontraten". Referuar Ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 1, pika 2 percaktohet: c) te nxise

*pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik; ç) te nxise konkurrencen ndermjet operatoreve ekonornike; Te njejtin qendrim ka mbajtur Komisioni i Prokurimit Publik ne vendimin Nr.748/2017: Kerkojme modifikimin e kriterit duke hequr vitin e prodhimit te mjeteve dhe paraqitjen e mjeteve me Kontrate Porosie ose blerje me kusht.”. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.4.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” pika 8 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

*Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:*

- e) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës **10-12 ton** raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2014 dhe jo më pak se niveli i emetimit të gazeve Euro 6, jo më pak se **2 (dy) copë**;*
- f) Makinë transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 2 ton, jo më pak se **1 (një) copë**;*
- g) Makina për Lagien e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për Lagien e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10,000 litra ujë jo më pak se **1 (një) copë**;*

*Mjete teknologjike rezervë:*

- h) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës **8-12 ton** raport kompaktimi 1:4 - 1:6 **2 (dy) copë**;*

*Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 8, gërma a – d, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:*

- p) Mjetet në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie, leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracion të mjetit.*
- q) Mjetet me qira duhet të shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (original ose kopje e noterizuar) së bashku me leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracion të mjetit. Kontrata e qirasë duhet të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qira të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi).*
- r) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- s) Për mjetet në pronësi/qira operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku autorizon autoritetin kontraktor të kryejë verifikimin fizik të mjeteve sipas Specifikimeve Teknike të deklaruara në procedurën e prokurimit si dhe te deklarojë adresen e sakte te vendndodhjes se mjeteve me qellim verifikimin e tyre si edhe të deklarojë që mjetet të mos jenë të angazhuara në kontrata të tjera.*
- t) Si mjete dhe pajisje për kryerjen e shërbimit, operatori ekonomik duhet të dëshmojë se disponon jo më pak se 300 kontenierë me volum 1.1, shoqëruar me akt pronësie, akt zhdoganimi, faturë tatimore blerjeje/ose me qira. Në rast se pajisjet disponohen me*

*qira operatori ekonomik duhet të dorëzojë kontratën e qirasë të vlefshme përgjatë gjithë periudhës së kontratës shoqëruar me aktin e pronësisë së qiradhënësit. Kontenierët duhet të përmbushin standardet EN 840 dhe RAL ose ekuivalent vërtetuar kjo e fundit me certifikatë cilësie. Për paisjet e mësipërme të dorëzohen edhe katalogët përkatës.*

III.4.2. Në datën 17.02.2021 autoriteti kontraktor ka publikuar një shtojcë në sistemin elektronik të prokurimeve, duke bërë modifikimin e kriterit të mësipërm si vijon:

*Ishte:*

*Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:*

- i) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës **10-12 ton** raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2014 dhe jo më pak se niveli i emetimit të gazeve Euro 6, jo më pak se **2 (dy) copë**;*
- j) Makinë transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 2 ton, jo më pak se **1 (një) copë**;*
- k) Makina për Lagien e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për Lagien e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10,000 litra ujë jo më pak se **1 (një) copë**;*

*Mjete teknologjike rezervë:*

- l) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës **8-12 ton** raport kompaktimi 1:4 - 1:6 **2 (dy) copë**;*

*Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 8, gërma a – d, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:*

- u) Mjetet në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie, leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracion të mjetit.*
- v) Mjetet me qira duhet të shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje e noterizuar) së bashku me leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracion të mjetit. Kontrata e qirasë duhet të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qira të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi).*
- w) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- x) Për mjetet në pronësi/qira operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku autorizon autoritetin kontraktor të kryejë verifikimin fizik të mjeteve sipas Specifikimeve Teknike të deklaruara në procedurën e prokurimit si dhe të deklarojë adresën e sakte të vendndodhjes së mjeteve me qëllim verifikimin e tyre si edhe të deklarojë që mjetet të mos jenë të angazhuara në kontrata të tjera.*
- y) Si mjete dhe pajisje për kryerjen e shërbimit, operatori ekonomik duhet të dëshmojë se disponon jo më pak se 300 kontenierë me volum 1.1, shoqëruar me akt pronësie, akt*

zhdoganimi, faturë tatimore blerjeje/ose me qira. Në rast se pajisjet disponohen me qira operatori ekonomik duhet të dorëzojë kontratën e qirasë të vlefshme përgjatë gjithë periudhës së kontratës shoqëruar me aktin e pronësisë së qiradhënësit. Kontenierët duhet të përmbushin standardet EN 840 dhe RAL ose ekuivalent vërtetuar kjo e fundit me certifikatë cilësie. Për pajisjet e mësipërme të dorëzohen edhe katalogët përkatës.

**Bëhet:**

*Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:*

- e) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10-12 ton raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2013 dhe jo më pak se niveli i emetimit të gazeve Euro 6, jo më pak se 2 (dy) copë;*
- f) Makinë transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 2 ton, jo më pak se 1 (një) copë;*
- g) Makina për Lagien e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për Lagien e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10,000 litra ujë jo më pak se 1 (një) copë;*

*Mjete teknologjike rezervë:*

- h) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 8-12 ton raport kompaktimi 1:4 - 1:6 2 (dy) copë;*

*Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 8, gërma a – d, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:*

- f) Mjetet në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie, leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracion të mjetit.*
- g) Mjetet me qira duhet të shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje e noterizuar) së bashku me leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracion të mjetit. Kontrata e qirasë duhet të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qira të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi).*
- h) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- i) Për mjetet në pronësi/qira operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku autorizon autoritetin kontraktor të kryejë verifikimin fizik të mjeteve sipas Specifikimeve Teknike të deklaruara në procedurën e prokurimit si dhe të deklarojë adresën e sakte të vendndodhjes së mjeteve me qëllim verifikimin e tyre si edhe të deklarojë që mjetet të mos jenë të angazhuara në kontrata të tjera.*
- j) Si mjete dhe pajisje për kryerjen e shërbimit, operatori ekonomik duhet të dëshmojë se disponon jo më pak se 87 kontenierë me volum 1.1, shoqëruar me akt pronësie, akt zhdoganimi, faturë tatimore blerjeje/ose me qira. Në rast se pajisjet disponohen me qira operatori ekonomik duhet të dorëzojë kontratën e qirasë të vlefshme përgjatë*



*gjithë periudhës së kontratës shoqëruar me aktin e pronësisë së qiradhënësit. Kontenierët duhet të përmbushin standardet EN 840 dhe RAL ose SSH ose ekuivalent vërtetuar kjo e fundit me certifikatë cilësie. Për pajisjet e mësipërme të dorëzohen edhe katalogët përkatës.*

III.4.3. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, si dhe kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar operatorit ekonomik ankimues me shkresën nr 534/1 prot datë 10.02.2021, arsyetohet si më poshtë:

*“[...] Ankimuesi pretendon se kërkesa se operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmerinë e mjeteve, ka përcaktuar të dhënat teknike dhe sasi të përcaktuese për mjetet e mëposhtme: a) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor; me kapacitet mbajtës 10-12 ton raport kompaktimi 1:4, - 1:6;, e vitit të prodhimit jo më poshtë se 2014 dhe jo më pak se niveli i emetimit të gazeve Euro 6, jo më pak se 2 (dy) copë; b) Makinë transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 2 ton, jo më pak se 1 (një) copë; Për sa i përket ankesës së OE për sa më sipër, vlerësojmë se kjo pikë e ankesës pranohet pjesërisht duke kërkuar ndryshimin e kërkesës:*

*Nga: Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor; me kapacitet mbajtës 10-12 ton raport kompaktimi 1:4, - 1:6;, e vitit të prodhimit jo më poshtë se 2014 dhe jo më pak se niveli i emetimit të gazeve Euro 6, jo më pak se 2 (dy) copë;*

*Në: Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor; me kapacitet mbajtës 10-12 ton raport kompaktimi 1:4, - 1:6; e vitit të prodhimit jo më poshtë se 2013 dhe jo më pak se niveli i emetimit të gazeve Euro 6, jo më pak se 2 (dy) copë; [...]”.*

III.4.4. Në nenin 63, pika 1, 1.1 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se: “Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.”. Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”

III.4.5. Referuar lex specialis, ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar strictu senso parashikohet se ankimi administrativ pranë autoritetit kontraktor dorëzohet me shkrim brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Në rastin konkret KPP konstaton, se ankimuesi ka marrë dijeni për kërkesat e autoritetit kontraktor nga publikimi i dokumenteve të tenderit në SPE në datën 02.02.2021 si dhe nga modifikimi i tyre në datën 17.02.2021, si dhe kthim përgjigja me shkresën nr. 534/1 prot, datë 10.02.2021. Referuar materialeve të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrative, KPP konstaton se operatori ekonomik ankimues në lidhje me pretendimet e mësipërme shtesë, nuk ka ezuaruar ankim administrativ pranë autoritetit kontraktor në respekt të nenit 63 të LPP-së, si një shkallë e parë e ankimit administrativ, por ka parashtruar pretendime vetëm pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik “Rej” shpk pranë K.P.P. në lidhje me pretendimet e mësipërme, nuk ka respektuar shkallët e ankimit, për sa kohë që autoriteti kontraktor me anë të kthim përgjigjes me shkresën nr. 534/1 prot, datë 10.02.2021, ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës për pretendimin e ngritur, për të cilin ka publikuar edhe shtojcë më datë 17.02.2021 në sistemin e prokurimeve elektronike, ku pas këtij momenti procedural operatori ekonomik ankimues duhej ti drejtohej sërish autoritetit kontraktor nëpërmjet ankesës, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “*elementet e domosdoshëm të ankesës*”, referuar nenit 26, pikës 3, shkronja “a”, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, ndaj dhe përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimit. Komisioni Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (*ndër to dhe ai i ankimit*), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si lex specialis mbi lëndën.

III.4.6. Duke mbajtur në konsideratë faktin, që sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i shkallëve të ankimit që duhet të ndjekë një ankim administrative, pasi për faj të vetë ankimuesit, ankimi nuk është realizuar sipas kritereve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”.

Pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik “Rej” shpk nuk merren në shqyrtim.

III.4.7. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për sa i përket disponueshmërisë së mjeteve, KPP konstaton se autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues, ka argumentuar se: “*Në lidhje me disponueshmërinë e mjeteve janë përzgjedhur dy format e kodit civil, pronësia dhe disponimi me anë të kontratës*

së qirasë por dhe kontrata të tjera që përcakton ligji mjafton që ajo të provojë disponueshmërinë e mjeteve sipas LPP dhe Kodit Civil”. KPP konstaton se nga ana e autoritetit kontraktor në sistemin e prokurimeve elektronike është bërë publikimi i shtojcës përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike por nuk ka pasqyruar ndryshimin e kriterit të kundërshtuar nga operatori ekonomik ankimues. Nisur nga kjo, Komisioni i Prokurimit Publik, thekson se, autoriteti kontraktor në hartimin e kriterëve për kualifikim duhet të ketë parasysh që hartimi i tyre duhet të jetë i qartë dhe i kuptueshëm edhe për personat me aftësi të kufizuara. Në këtë kuptim, në lidhje me disponueshmërinë e mjeteve, nisur nga pretendimi i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, KPP gjykon se autoriteti kontraktor nuk duhet të kufizohet vetëm në kërkesën për mjetet me qira ose në pronësi, në kushtet kur disponueshmëria e tyre mund të vërtetohet edhe me forma të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, duke mos krijuar barriera e pengesa në lidhje me kriterin për mjetet, por duke krijuar lehtësi për konkurrencë të hapur për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar të cilët kanë disponueshmërinë e mjeteve në një prej formave që njeh legjislacioni në fuqi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron dhe autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin përkatës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me pretendimin se: “Në DST, Kriteret e Veçanta për Kualifikim, Kapaciteti Teknik nen pika 0 kërkohet: Operatori nga dita e shpalljes së procedurës deri në momentin e hapjes së ofertave duhet të paraqesë mostra për artikujt e mëposhtëm: 1 kontenierë me volum 1.1 të shoqëruar me kopje të certifikatës së cilësisë për përmbushjen e standardeve EN 840 dhe RAL ose ekuivalent. Vendosja e këtij kriteri nga AK çënon fshehtësinë e procesit për pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit publik. Ky kriter nuk mund të jetë kusht për skualifikim. AK mund të kërkojë paraqitjen e mostrës për kontenierin 1.1 pas dorëzimit të ofertave në një datë dhe vend të caktuar nga ai. Kërkojmë nga AK heqjen e këtij kriteri nga kriteret e veçanta për kualifikim. Kërkojmë pranimin e ankesës dhe modifikimin e kriterëve të veçanta për kualifikim si më sipër të argumentuara dhe të mbështetura në prova dhe ligj.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca 8/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 10, “Për kapacitetin teknik”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

*Operatori nga dita e shpalljes së procedurës deri në momentin e hapjes së ofertave duhet të paraqesë mostra për artikujt e mëposhtëm:*

*1 kontenierë me volum 1.1 të shoqëruar me kopje të certifikatës së cilësisë për përmbushjen e standardeve EN 840 dhe RAL ose ekuivalent.*

III.5.2. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me

*natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*

III.5.3. Në nenin 27, pika 6, e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

*a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit dhe/ose*

*b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogët teknike; dhe/ose*

*c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.*

III.5.4. Komisioni gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.5.5. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret K.P.P. konstaton se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. KPP konstaton se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit kriteret kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik të operatorëve ekonomik të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimin të kryerjes me sukses të shërbimit të kërkuar, ndaj dhe kërkesa e autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e mostrës është e ekzagjeruar dhe nuk i shërben autoritetit kontraktor që të vërtetojë përmbushjen e kapaciteteve teknike apo realizimit me sukses të kontratës, për sa kohë që kemi të bëjmë me procedurë shërbim pastrimi dhe jo blerje malli. Në këto kushte, KPP gjykon se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e

mostrave nuk është në përputhje me nenin 27 pika 6 gërma “a” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ndaj kërkesa për dorëzimin e mostrave *I kontenierë me volum 1.1 te shoqeruar me kopje te certifikates se cilesise per pambushjen e standardeve EN 840 dhe RAL ose ekuivalent, duke ju referuar edhe përmasave fizike të saj*, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Për këtë arsye, autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e kriterit të sipërcituar sipas konstatimit të mësipërm duke hequr kërkesën e paraqitjes së mostrës *I kontenierë me volum 1.1*.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë.

#### **Vendos**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF- 85499-02-01-2021, me objekt “Shërbim i pastrimit, grumbullimit dhe largimit të mbetjeve të qytetit Cërrik dhe Njësive Administrative”, me fond limit 24,951,604 lekë pa tvsh, publikuar më datë 02.02.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Cërrik.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë ankimues “Rej” ShPK
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 259 Protokoli, Datë 17.02.2021**

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**